

Seance's Plenary



REPUBLIK A E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2024

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Zhenid Klasi
Zhenid Klasi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR

NJË SHITESË NË LIGJIN NR.29/2023, "PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin
deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pas shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të
ardhurat", të ndryshuar, shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) entitetet që operojnë në struktura akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë
yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që
janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand
name*", përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10-
vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026.

Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të
strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

ELISA SPIROPALI

Miraturar në datën _____

Ishqiptaria.com

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.29/2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR””

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ka për qëllim të përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës entitetet që operojnë në struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10-vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.

Ky projektligj synon incentivimin e sektorit të turizmit duke ulur normën tatimore në 0% për 10 vitet e para fiskale, për strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektligji është në harmoni me politikat e qeverisë për të lehtësuar struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, me qëllim investimin në këto struktura.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Turizmi shqiptar është ende në zhvillim dhe aktualisht has vështirësi të konkurrojë me nivelin dhe cilësinë që ofrojnë hotelet dhe resortet e vendeve të rajonit. Për zhvillimin e turizmit krahas numrit të lartë të turistëve, mbi të gjitha

nevojitet një infrastrukturë e gjerë dhe tepër cilësore e hoteleve apo resorteve, të cilin vetëm grupet hoteliere me eksperiencë mund ta ofrojnë. Nga ana tjetër, tendenca aktuale e vendeve të Ballkanit është dhënia e incentivave në forma nga më të ndryshmet, me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorin e turizmit dhe veçanërisht përmirësimin e stukturave hoteliere të standartit të lartë (hotele/resorte me katër dhe pesë yje). Këto incentiva synojnë gjithashtu zhvillimin e sektorit të turizmit, dhe mbi të gjitha të përmirësojnë imazhin e vendit tonë.

Përpos kësaj nxitja e investimeve në sektorin e turizmit do të kontribuojë gjithashtu edhe në:

- hapjen e vendeve të reja të punës,
- rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve me potencial të madh të fuqisë blerëse që do të qëndrojnë në Shqipëri,
- rritjen e konsumit si një faktor të rëndësishëm në rritjen e GDP.

Aktualisht, vendet e rajonit kanë zgjedhur forma të ndryshme të incentivimit për përmirësimin e klimës së turizmit.

Serbia, përjashton për 10 vjet nga tatim fitimi, ato investime në turizëm të cilat kalojnë vlerën 8 milion euro, si dhe punësojnë të paktën 100 persona.

Në këmbim të investimeve në turizëm, Turqia parashikon lehtësi të shumta për tatimin mbi të ardhura në burim dhe tatimin mbi të ardhurat, konkretisht deri në 90% reduktim të tatimit mbi fitimin apo të tatimit mbi të ardhurat personale. Në përgjithësi, reduktimi i taksave në Turqi bëhet për një periudhë kohore që nuk i kalon 10 vjet.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën dhe me legjislacionin në tërësi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVË).

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projektligji parashikon që pas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) entitetet që operojnë në struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10-vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohet Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.